



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 14
Prishtinë, më 28 mars 2018, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302-

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Driton Selmanaj, Andin Hoti, Muharrem Nitaj, Shqipe Pantina, Avdullah Hoti, Ali Lajçi, Zafir Berisha dhe Albert Kinolli,

Munguan: Faton Topalli, Mërgim Lushtaku dhe Verica Çeraniq.

Stafi mbështetës i komisionit: Mehmet Simnica.

Pjesëmarrësit tjerë: Bajram Zejnullahu, Ekrem Hajdari dhe Adem Selishta nga AKP-ja; Vlora Spanca, Bahri Statovci dhe Enver Basholli nga ZKA-ja; Mentor Hyseni nga GIZ; Elira Tahiri nga KDI; Sanie Jusufi nga “Koha Ditore” dhe Valbona Bytyqi nga “Ekonomia Oline”.

Mbledhjen e kryesoi: Driton Selmanaj, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.03.2018;
3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për raportin financiar vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016;
4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për raportin financiar vjetor të Fondeve të Mirëbesimit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016;
5. Të ndryshme.

Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 23.3.2018

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 23.3.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të auditimit për raportin financiar vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016

Kryetari njoftoi se sot jemi mbledhur për të shqyrtuar raportin e auditimit për AKP-në dhe për FM. Më tej, po ashtu për detajet ftoi përfaqësuesit e Zyrës Kombëtare të Auditimit të prezantojnë të gjeturat e raportit për AKP-në dhe FM-në. Opinioni i auditimit për PVF-të e AKP-së për vitin 2016, ZKA ka dhënë Opinion të Kualifikuar. Ne kemi krijuar bazën për opinionin të kualifikuar, për arsye se AKP në tabelën e dytë të pasqyrave financiare vjetore “Raporti i ekzekutimit të Buxhetit” te hyrja e parasë së gatshme në llogarinë e thesarit, shuma e realizimit për të Hyrat e dedikuara ishte e pasaktë, respektivisht ishte vendosur shuma e ndarjeve të buxhetit final duke e mbivlerësuar këtë zë për 887,797€. Rekomandimet nga viti paraprak, raporti ynë i auditimit për PVF-të e vitit 2015 të AKP-së ka rezultuar me 16 rekomandime kryesore. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, vetëm 4 (katër) rekomandime ishin zbatuar plotësisht, 6 (gjashtë) janë zbatuar pjesërisht dhe 6 (gjashtë) nuk janë zbatuar ende. Kjo ka ndodhur për shkak se AKP nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP-së. Qeverisja dhe raportimi, auditimi ynë ka identifikuar një numër të mangësive në qeverisje brenda AKP-së veçanërisht në lidhje me kontrollet menaxheriale, menaxhimin e rrezikut, cilësinë e raportimit menaxherial dhe mos zbatimi i tërësishëm i rekomandimeve të vitit të kaluar nga auditimi i jashtëm janë çështje të cilat AKP-ja duhet t'i ketë parasysh për të përmirësuar qeverisjen brenda saj. Auditimi i brendshëm, njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) kishte hartuar planin e punës duke u bazuar në strategjinë për periudhën kohore 2014-2016. Për vitin 2016, NJAB kishte planifikuar gjithsejtë 8 (tetë) auditime, 3 (tri) prej të cilave mbulonin aktivitetet e menaxhimit të Agjencisë si Organizatë Buxhetore, ndërsa 5 (pesë) të tjera mbulonin aktivitetet e menaxhimit të Fondeve në Mirëbesim. NJAB kishte dhënë rekomandime për fushat e audituara dhe këto ishin trajtuar edhe në takimet e Bordit të Drejtorëve. Menaxhimi financiar dhe kontrolli sa i përket menaxhimit financiar dhe kontrollit AKP kishte dizajnuar një sistem të raportimit nga drejtorët e departamenteve të menaxhimit. Megjithatë, një numër i proceseve qeverisëse duhet të përmirësohen, për të mbështetur menaxhimin efektiv të aktiviteteve të Agjencisë. Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi një sërë fushash të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të siguruar menaxhimin e kontratave në pajtim me kërkesat ligjore. Po ashtu, kontrollet në menaxhimin e dosjeve të personelit, planifikimin e prokurimit për mallra dhe shërbime, menaxhimin e pasurisë dhe detyrimeve kanë nevojë për përmirësim të mëtutjeshëm. Pagat dhe menaxhimi i personelit, në fushën e shpenzimeve për pagat dhe menaxhimi i personelit janë evidentuar disa mangësi duke përfshirë: Në 3 (tri) raste kualifikimet profesionale nuk ishin relevante me pozitën përkatëse; Në 3 (tri) raste mungonin kopjet e diplomave ndërsa në 2 (dy) raste ishin vetëm certifikatat për përfundimin e studimeve; Në 2 (dy) raste diplomat e fituara jashtë Kosovës nuk ishin të nostrifikuara sipas udhëzimit administrativ të MASHT nr. 16/2016; Në 2 (dy) raste në pozitën zyrtare ishin caktuar ushtrues detyre që nga viti 2014 dhe 2015, të cilët ende vazhdojnë të jenë ushtrues detyre. Sipas Ligjit për shërbimin civil (neni 30.4), ushtrues detyre nuk mund të emërohen më gjatë se tre muaj; Në 22 raste, emërtimet e pozitave në akt emërimi nuk ishin të listuara në rregulloren e pagave të nëpunësve të AKP-së, kjo ka krijuar mos pajtueshmëri me përshkrimin e emërtimeve të pozitave; dhe Raporti përmbledhës vjetor për vlerësimin e

performancës nuk ishte dorëzuar brenda afatit kohor të Ministrisë e Administratës Publike (MAP). Sipas rregullores nr. 19/2012 ky raport duhet të dorëzohet në MAP deri më 15 janar të vitit pasues, ndërsa ishte dorëzuar më 15 shkurt.

Shpenzimet përmes prokurimit, gjatë testimeve të shpenzimeve dhe procedurave të prokurimit kemi identifikuar mangësitë si më poshtë në vijim: Përgatitja e mirë e planit të prokurimit do të eliminonte nevojën për prokurime emergjente dhe ndarjen e kërkesave. Në 1 (një) rast ishte zhvilluar procedurë emergjente e cila ka mundur të planifikohej dhe në 3 (tri) raste për blerje të TI-së ishin ndarë kërkesat e prokurimit e që ishin të njëjta dhe të ndërlidhura. Në 3 (tri) raste menaxheri i kontratës nuk kishte përgatitur planin për menaxhimin e kontratës siç kërkohet me rregullat dhe udhëzuesin operativ të prokurimit publik; dhe në 1 (një) rast anëtari i komisionit të vlerësimit ishte emëruar edhe menaxher i kontratës së njëjtë. Sipas rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurim publik asnjë anëtarë i komisionit të vlerësimit nuk mund të emërohet si menaxher i projektit. Çmimi i përmendur në kontratë duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të shërbimeve sipas kontratës. Sipas memorandumit për veprim të datës 01.09.2016 menaxhmenti i AKP-së kishte aprovuar pagesat e faturave për rastet e tejkalimit të kontratave për vitin 2013 në shumë 34,725€ për shërbimet e përkthimit, shërbimet postare, dizajnim i reklamës dhe gazetave vendore dhe ndërkombëtare. Kjo për shkak të keq menaxhimit të kontratave nga personat përgjegjës për menaxhimin e kontratave të vitit 2013. Sipas AKP-së, këto pagesa ishin bërë më qëllim të shmangies së ndëshkimeve dhe interesave për pagesa të vonuara.

Vlora Spanca paraqiti në pika të shkurtra opinionin e dhënë të auditimit për AKP- në për vitin 2016, si dhe përmendi disa të gjetura kyçe.

Përfundim

KMFP vendosi që raporti i auditimit për PVF-të e AKP-së për vitin 2016, të mos adresohet për në Seancë Plenare, megjithatë rekomandimet t'i drejtohen bordit të drejtorëve të AKP-së.

4. Shqyrtimi i raportit të auditimit për raportin financiar vjetor të Fondeve të Mirëbesimit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016

Kryetari theksoi për PVF-të e Fondeve në Mirëbesim për vitin 2016. ZKA ka dhënë Opinion të Kualifikuar. ZKA ka krijuar bazën për Opinion të Kualifikuar, për arsyet e përmendura në vijim: Pagesat për Ofruesin e Shërbimeve Profesionale (OSHP) për vitin 2016 në vlerë prej 3,713,028€ ishin bërë nga Fondet në Mirëbesim. Bazuar në ligjin e AKP-së sipas nenit 16, kompensimi i afruesve të shërbimeve profesionale kryhet nga mjetet që i janë ndarë Agjencisë nga Buxheti i Republikës së Kosovës ose nga mjetet e siguruar nga një donator. Rekomandimet nga viti paraprak: auditimi i PVF-ve për vitin 2015 të AKP-së ka rezultuar në 8 (tetë) rekomandime të Fondeve në Mirëbesim. Agjencia Kosovare e Privatizimit kishte përgatitur planin e veprimit ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, vetëm 2 (dy) rekomandime ishin zbatuar plotësisht, 3 (tri) ishin zbatuar pjesërisht, ndërsa 3 (tri) nuk janë zbatuar ende. Qeverisja e Fondeve në Mirëbesim në lidhje me raportimin menaxherial dhe llogaridhënien, si dhe menaxhimin e rrezikut nuk ka siguruar që sistemet financiare funksionojnë në mënyrë të duhur. Kontrollat mbi menaxhimin e përgjithshëm të Fondeve në Mirëbesim kanë nevojë për përmirësime. Shfrytëzimi i mjeteve të FM-së për pagesat e OSHP-së të cilat sipas Ligjit duhet të kryhen nga buxheti i AKP-së është çështje e cila kërkon trajtim të veçantë nga menaxhmenti i AKP-së. Po ashtu, kontrollat mbi të hyrat në përgjithësi

nuk janë në nivelin e duhur dhe nuk janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Me theks të veçantë, kontrollet ekzistuese në zbatimin e rregullores së qiradhënies së aseteve të NSH-ve duhet të përmirësohen. Më tutje, niveli i ulët i përmbushjes së procesit të likuidimit deri me 31 dhjetor 2016, dhe pengesat e paraqitura, kanë rritur rrezikun që procesi mos të finalizohet në afatin e përcaktuar kontraktual. Kjo ka ndikuar në rritjen e shpenzimeve, si dhe në përmbushjen e misionit të AKP-së. Si pasojë e mos përmbushjes me kohë të procesit të likuidimit, AKP kishte lidhur aneks kontrata për të vazhduar me procesin e likuidimit. Llogaritë e arkëtueshme kishin trend të rritjes edhe gjatë vitit 2016, përkundër rritjes së tyre BD i AKP-së nuk kishte marrë veprimet e nevojshme për trajtimin e llogarive të arkëtueshme, arkëtimin e tyre, apo ndarjen e provizioneve për to. Sipas rregullores për qiradhënien e aseteve të NSH-ve, kërkohet që lista e propozimeve për qiradhënie të dërgohet te BD për miratim. Pas miratimit të BD, asetet do të lëshohen me qira përbrenda afatit optimal të vendosur nga menaxhmenti. Në 18 raste kontratat për qiradhënie ishin nënshkruar pa miratimin nga BD. Në 11 raste ishin nënshkruar kontrata për qira me qiramarrësit pa i kryer obligimet e papaguara për kontratat paraprake. Në 1 (një) rast qiramarrësi nuk kishte nënshkruar vazhdimin e kontratës, përderisa kishte vazhduar që të shfrytëzojë objektin, por kishte vazhduar që të bëjë pagesat; dhe Departamenti i koordinimit rajonal edhe pse kishte progres në mbledhjen e qirasë, nuk ishte në gjendje të afrojë raport përmbledhës për gjendjen e qirave më 31 dhjetor 2016. Sipas raportit të autoritetit të likuidimi të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve, gjendja e fondeve të mbetura pasi që janë zgjedhur të gjitha kërkesat/ ankesat e kreditorëve për NSH e shitura deri më 31 dhjetor 2016 ishte 39,456,444€. Agjencia vazhdon t'i mbajë në mirëbesim këto mjete edhe me tutje për mungesë të një baze ligjore për trajtimin e tyre. Ne e sugjerojmë AKP që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar bazën ligjore, që pas mbylljes së procesit të likuidimit të NSH-ve fondet e mbetura të transferohen nga Agjencia në Qeverinë e Kosovës. Me këtë hapi diskutimin.

Ekrem Hajdari, gjatë diskutimit të tij, sqaroi se raporti i takon periudhës në të cilën ai nuk ka qenë drejtor i këtij institucioni. Ndërkaq shtoi se është i gatshëm që të marrë përgjegjësitë që kanë dalë nga ky raport i auditimit, si dhe rekomandimet që dalin nga Komisioni. Ndërsa, theksoi rekomandime të pa plotësuara ai dha sqarime më të detajuara. Drejtori ka folur edhe për mangësitë e tjera që janë hasur nga auditori gjatë asaj periudhe, duke shtuar se tashmë gjendja ka ndryshuar për të mirë.

Vlora Spanca paraqiti në pika të shkurtra opinionin e dhënë të auditimit për FM-in, për vitin 2016, si dhe përmendi disa të gjetura kyçe.

Ali Lajçi, Pyeti se kemi një listë nga Qeveria që objektet publike ushtrimi i veprimtarive të disa ministrive apo Institucioneve Shtetërore ushtrohen në disa nga objektet të cilat merren me qira. Kemi një fond të buxhetit i cili destinohet për pagesa. Kurse kemi objekte ku faktikisht janë pronë e Qeverisë dhe nuk ushtrohet veprimtari së vet që e ka, sa janë ato objekte, cilat janë ato dhe kush i ka me qira ato objekte?

Muharrem Nitaj: Ju z. Selishta deklaruat se kontratat për qira i keni bërë në kohën kur nuk ka ekzistuar Bordi i Drejtorëve të Agjencisë. A është korrekte kjo? Cilat kanë qenë komisionet që ju keni krijuar? A keni qenë të vetëdijshëm që ky veprim është në kundërshtim me rregulloren, faktikisht janë edhe veprime të kundërligjshme.

Adem Selishta tha se është periudha në të cilat nuk ka pas Bord Drejtorëve dhe është filluar me lirim e aseteve të uzurpuara, shpalljet kanë qenë të hapura dhe publike.

Zafir Berisha tha duke vazhduar me mos zbatimin të rekomandimeve nga viti paraprak, kjo nënkupton injorimin e Institucioneve dhe vazhdimi i anarkisë për X çështje. Andaj pyeti se çfarë masa keni ndërmarrë Ju, si menaxhment, ndaj atyre që nuk kanë zbatuar rekomandimet. Duke përfshirë edhe Kuvendin në mos zbatim të rekomandimeve?

Albert Kinolli: Dua përgjigje konkrete të shpenzimet përmes prokurimit ku sipas rregullave të Prokurimit Publik, as një anëtar i komisionit nuk mund të emërohet si menaxher i projektit, me një rast anëtar i komisionit vlerësues është emëruar edhe menaxher i kontratës, për mendimin tim kjo është shkelje. Si e shiheni edhe si e vlerësoni ju?

Kryetari, pasi nuk pati të interesuar për të diskutuar për këtë pikë, propozoi si në përfundim.

Përfundim

KMFP vendosi që raporti i auditimit për PVF-të e FM për vitin 2016, të mos adresohet për në seancë plenare, megjithatë rekomandimet t'i drejtohen bordit të drejtorëve të FM-së.

5. Të ndryshme

Kryetari njoftoi deputetët se për të mërkurën, datë 04.04.2018 kemi një vizitë në Zyrën e Kombëtare të Auditimit në orën 11:30. Vizite kjo e paraparë edhe me planin e punës së KMFP-së për vitin 2018. Kërkoj po ashtu nga Administrata e Komisionit të bënë përgatitjet për këtë takim. Me këtë, takimi përfundoi.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Driton Selmanaj